

**AKT THEMELIMI DHE STATUT**  
**ISHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“BONTY” SHPK**

Sot me dt. 27.03.2023 , mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise, te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, " Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit Nr. 131/2015 Per QKB dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare, me vullnetin e tyre te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi dhe statuti nga ortaku :

I. Z. Gazmend Lleshi , i datelindjes 22.03.1980, lindur e banues ne Shperdhjet, Mamurras,i pajisur me karte identiteti nr., 034203950 dhe Id. I00322082P, shtetas shqiptare, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar.

**KREU 1**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1. Forma dhe Emri**

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur **“BONTY”** sh.p.k.

Shoqeria ka formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me inicialet SHPK qe vijne menjehere pas emrit te shoqerise. Kjo shoqëri i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltarte shoqërise.

Forma dhe emri i shoqërise mund te ndryshohen me vendim të Ortakut te Vetem.

**Neni 2. Baza Ligjore**

Shoqëria është themeluar dhe do te funksionojë përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 dhe Ligiin Nr. 9901, datë 14.04.2008, në përputhje me legjislacionin shqiptare në përgjithsi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet ndërkombetare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.



Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që shoqëria i drejton ortakëve sipas këtij statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen se janë kryer në mënyrë të rregullt kur dërgohen ortakëve në adresat e deklaruara prej tyre pranë administratorit (eve) të shoqërisë.

Në kuptim të këtij statuti, shprehjet në njëjës përfshijnë ato në shumës dhe anasjelltas me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës rezulton ndryshe. Përemri vetor “ai” përfshin edhe përemrin vetor “ajo” dhe përemrin vetor “ate”, nënkuptohen të dyja gjinitë me përjashtim të rasteve kur sipas kontekstit të dispozitës rezulton ndryshe.

## **KREU 2**

### **ORTAKET, SELIA, STATUTI, KOHEZGJATJA, VULA**

#### **Neni 3. Ortaku/et**

Ortak i vetëm i shoqërisë është z . Gazmend Lleshi , i datelindjes 22.03.1980, lindur e banues në Shpërdhet, Mamurras, i pajisur me kartë identiteti nr., 034203950 dhe Id. I00322082P, shtetas shqiptarë, madhore me zotësi juridike dhe për të vepruar.

#### **Neni 4. Selia**


Selia e shoqërisë tregtare private **“BONTY”**sh.p.k. do të ketë selinë e saj, në ndërtesën me nr. Pasurie1/1054+2-N3, Rruga Sali Budka, Njesia Administrative nr. 7, Zona Kadastrale nr. 8250, Tiranë.

#### **Neni 5. Statuti**

Shoqëria do të ketë statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin fillestar.

#### **Neni 6. Kohezgjatja**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon

2  


në procedure likuidimi me vendim të ortakut të vetem, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

**Neni 7. Vula**

Shoqëria ka vullen e saj .

**KREU 3**

**OBJEKTI, KAPITALI, TE DREJTAT E ORTAKEVE**

**Neni 8 . Objekti**

Shoqëria ka për Objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

- a) Tregti me shumice dhe pakice, Import-eksport të veshjeve, aksesore për veshjeve, , tekstileve, mallrave industriale, e ushqimore;
- b) Tregtim me shumice dhe pakice të materialeve ndryshme për kancelari. Tregti me shumice dhe pakice të printerave , kompjuterave , boje printeri, pjesë për kompjutera dhe printera si dhe pajisje të tjera informatike . Import dhe eksport të materialeve të ndryshme për kancelari , të printerave , kompjuterave , boje printeri, pjesë për kompjutera dhe printera si dhe pajisje të tjera informatike;
- c) Transport mallrash;
- d) Prodhim dhe tregtim të materialeve të ndërtimit, Ndërtime civile dhe ekonomike, asfaltim rrugësh, punime mirëmbajtjeje, sinjalistike, tregtim dhe shitje inertesh, etj.;
- e) Veprimtari në fushën e përpunimit dhe përfundimit të materialeve me mall të porositesit;
- f) Punime artistike, qendistari, rrobaqepesi, bizhuteri;
- g) Aktivitet në fushën e hoteleri turizmit, bar ,restorant, pasticeri;
- h) Tregti karburantesh, elektroshtepiake, konfeksione, pjesë këmbimi, artikuj druri, kozmetik, makineri industriale, bujqësore dhe blegtorale.
- i) Shërbimeve si agjenci udhëtimi, turistike, kombëtare e ndërkombëtare ajrore, toksore e detare. Shërbime: Parkim Automjete
- j) Shërbime ,artizanale, elektrike, hidraulike, pastrimit ambjentëve, automjeteve, krijimit dhe mirëmbajtjes së ambjentëve të gjelbra, krijim dhe mirëmbajtje sistem IT.
- k. Bujk për drithera , vreshta ullinj, pemë frutore, blektori, etj.



8.1 Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria:

a) Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj Ose të subjekteve pjesëmarrëse;

b) Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë trualli apo objektsh, operatorë dhe administrues të strukturave turistike;

c) Mund të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme ose të dobishme Ose që kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe së të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj Ose që mundëson një përdorim në të mirë të strukturave dhe/ose burimeve nëpërmjet shoqërive Ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.

4.3 Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushë Ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

#### **Neni 9. Kapitali**

Kapitali i shoqërisë është 100000 (Njëqind mijë) leke dhe perbehet nga 1 kuote me kontributin e ortakut të vetëm si më poshtë:

z . Gazmend Lleshi , me kartë identiteti nr Id. I00322082P, për 100000 (njëqind mijë), 100% të kapitalit , numri i votave 1.

Te gjitha kuotat e kapitalit themeltar janë të nënshkruara dhe të shlyera krejtësisht, dhe depozituar në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dytë.

#### **Neni 10. Te drejtat e ortakëve në lidhje me kapitalin**

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakesohet sipas vendimit të ortakut por asnjehere nuk mund të pakesohet në nivelin e kapitalit minimal ligjor.

Ortaku/et mund të shesin të tretëve kuotat e tij të kapitalit pjesërisht ose tërësisht. Shitja e kuotave tek të tretet do të bëhet vetëm pasi të ketë marrë vendim ortakut I vetëm në bazë të nenit 86 dhe 87 të ligjit të ligjit 9901 datë 14.04.2008.



Kapitali i shoqerise do te perbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe te tjera pasuri te nevojshme te luajteshme apo te paluajteshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet e lindura me pare ndaj shoqerise. Gjithashtu ai gezon te gjitha te drejttat e lindura para largimit te tij.

#### **KREU 4**

#### **ORGANET DREJTUESE, ASAMBLEJA E PERGJITHSHME, ORGANI ADMINISTRATIV**

##### **Neni 11. Organet drejtuese**

Organet drejtuese te shoqerise do te jene:

- Asambleja e pergjithshme e ortakeve e perbere nga Ortaku I vetem I shoqerise.
- Administratori

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit te organeve drejtuese rregullohet si me poshte.

##### **Neni 12. Asambleja e Pergjithshme**

Asambleja e pergjithshme e ortakeve (Ortaku I vetem) eshte organi me i larte vendimor. Ortaku I vetem (Asambleja e pergjithshme e ortakeve) merr vendime sa here e sheh te arsyeshme, por domosdoshmerisht per te miratuar pasqyrat financiare vjetore te shoqerise.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve (Ortaku I vetem) eshte pergjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c”



dhe “ç” të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

### **Neni 13. Organi administrativ**

Administrator i shoqërisë “**BONTY**” shpk emerohet z . Gazmend Lleshi , karte identiteti nr.Id. I00322082P. Mandati i administratorit do të jetë 5 vjet nga data e miratimit të tij. Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretet për përmbushjen e aktivitetit të saj në përputhje me nenin 8 të këtij statuti.

Organi Administrativ (administratori) ka të drejtë dhe duhet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakeve;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatit dhe nënshkruajnë pasqyrat financiare vjetore, dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;



- e) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryeje detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- f) marre ne pune persona te ndryshem dhe rregullimin e maredhenieve te punes me ta.
- g) perfaqesoje apo emeroje perfaqesues ne ceshtje gjyqesore qe mund te kete shoqeria ose ne ceshtje te tjera me pale te treta;

## **KREU 5** **KUSHTET EKONOMIKE**

### **Neni 14. kushtet ekonomike**

Shoqeria eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjetër juridik ne Shqiperi; mund te bleje, te shese, te jape ne perdorim , te ngarkoje me barre per detyrime ndaj te treteve ose per kredi bankare, etj.

Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese, si dhe librin e saj te llogarive ne baze te kerkesave te ligjit per kontabilitetin e dispozitave te tjera fiskale.

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do te kryhen ne baze te kritereve te caktuara nga Banka e Shqiperise.

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise nisin vitin e pare ne momentin e rregjistrimit ne organet tatimore, ndersa vite te tjera ne 1 Janar dhe mbyllen ne 31 Dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohen pasqyrat financiare sipas ligjeve ne fuqi. Pasqyrat financiare vjetore miratohen nga asambleja e pergjithshme e ortakeve dhe nenshkruhen nga administratori.

Fitimi neto i realizuar, pasi jane zbritur rezervat ligjore dhe tatimet sipas ligjeve ne fuqi, mbetet ne perdorim ortakeve te cilet vendosin per perdorimin e tij.



## **KREU 6**

### **MAREDHENIET E PUNES**

#### **Neni 15.**

Maredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republiken e Shqiperise. Mosmarveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykatën shqiptare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj, nese ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.

## **KREU 7**

### **DISPOZITA TE VECANTA**

#### **Neni 16. Mbarimi I shoqerise**

Veprimtaria e shoqerise pushon me vendim te Ortakut te vetem (Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve) te shoqerise per shkaqet:

- Sipas rasteve te parashikuara nga Ligji Tregtar
- pamundesi veprimi
- shperndahet me vullnetin e ortakut/eve.
- riorganizohet ne nje forme tjeter.

#### **Neni 17. Likuidimi**

Ne kushtet e nenit 19 te ketij statuti Ortaku I Vetem (Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve) cakton nje ose me shume likuidatore te cilet marrin ne dore drejtimin e shoqerise duke kryer te gjitha veprimet e likuidimit te saj, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprikes se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet ortakëve. Ndersa ne rastin e pamjaftueshmerise se kapitalit, ortakët e shoqerise jane te detyruar te derdhin kuotat e tyre deri ne nivelin e kuotave te kapitali themeltar.

#### **Neni 18. Mosmarveshjet**

Mosmarveshjet qe mund te lindin ne shoqeri me te tretet , zgjidhen me pajtim, ne te kundert palet i drejtohen Gjykates per zgjidhje.

### **DISPOZITA TE FUNDIT**





### **Neni 19**

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut (akt themelimi) i referohet plotesimeve qe do te bejne ortaket e shoqerise si dhe ligjeve te vecanta ne te cilat eshte referuar hartimi i ketij statuti.

Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxirret vete statuti.

### **Neni 20**

Ky akt themelimi dhe njekohesisht Statut I shoqerise u perpilua ne prani te ortakut te vetem te shoqerise duke shprehur vullnetin e saj te plote e te lire.

Ai u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarta secila, per t'u depozituar ne QKB e per t'u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Laç me 27.03.2023.

**ORTAKU I VETEM I**  
**SHOQERISE "BONTY" SHPK**

GAZMEND LLESHI

